



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Datë: 09.07.2025
Numër Protokolli: 4915/2025

A.nr.958/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas A.nr.958/2025, të datës 26.05.2025, të parashtruar nga ankuesi, M.K, kundër organit të punësimit: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 09.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.958/2025, e datës 26.05.2025, të parashtruar nga ankuesi, M.K.

A r s y e t i m

Ankuesi M.K (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 26.05.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër refuzimit të aplikacionit në procedurën e rekrutimit me nr. ref: RN00017405, për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit të Lejeve dhe Licencave*, të shpallur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ndërsa, kjo e fundit, më datë 13.06.2025, ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesi, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga provat e lëndës rezultoi se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 24.03.2025 ka shpallë konkursin publik me nr.ref: RN00017405, për pozitën e punës, Udhëheqës i Divizionit të Lejeve dhe Licencave, me klasë të pozitës Drejtues i Ulët, me mandat katër vjeçar, i hapur për aplikim nga data 25.03.2025 deri më datë 23.04.2025.

Rrjedhimisht nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 28 kandidatë, përfshirë edhe ankuesin, i cili sipas Njoftimit të datës 08.05.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, është njoftuar se nuk ka kaluar fazën e verifikimit paraprak me arsyetimin se me rastin e aplikimit nuk ka bashkangjitur dokumentin e identifikimit, gjegjësisht kopja e letërnjoftimit nuk ka qenë plotësisht e bashkangjitur.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar Njoftimin për refuzimin e aplikacionit, mbi pretendimin ankimor se me rastin e aplikimit për konkursin përkatës të punësimit ka bashkangjitur ID-në. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe ankuesit ti mundësohet e drejta e konkurrimit në këtë procedurë.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: *12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative, si dhe nenin 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi Nën Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.* Andaj, referuar këtij përcaktimi ligjor si dhe duke u bazuar në përgjigjen në ankesë të organit të punësimit ku konfirmohet së kjo procedura nuk ka përfunduar për shkak të pezullimit sipas kërkesës së Këshillit të datës 20.05.2025, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e parakohshme, ngase, kandidati për pranim në shërbim civil ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesi ka parashtruar ankesë ndaj njoftimit për refuzim të aplikacionit, si veprim procedural në fazën e verifikimit paraprak, kështu që, duke qenë së ankesa është parashtruar ende pa u shpallur njoftimi për rezultatin përfundimtar për procedurën përkatëse të rekrutimit, atëherë, në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ankesa A.nr.958/2025 është e parakohshme.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë e ankesës si parakohshme, nuk mohon të drejtën e ankuesit, që të kundërshtoj vendimin për refuzimin e aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Theksuar si me lart, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.958/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit, M.K;*
- *Udhëheqësit të Personelit në MMPHI dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK*